



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANI**

URDHËR

Nr. 7, datë 23.05.2018

**PËR MARRJEN E MASAVE PER PROVIMET E SEZONIT TE VERES PER VITIN
AKADEMIK 2017-2018 NE FAKULTETIN E ARTIT SKENIK**

Mbështetur në nenin 42 (Drejtuksi i Njësisë kryesore) si dhe nenin 25 (Departamenti) të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", duke marrë në konsideratë faktin se jemi në periudhën e përgatitjes së provimeve të semestrit të dytë,

Urdhëroj

1. Përgjegjësit e Departamenteve të jenë të pranishëm dhe të ndjekin gjithë provimet e programeve të studimeve që përfshin departamenti përkatës.
2. Nëse konstatohet mungesë anëtari komisioni në ndonjë rast të veçantë Përgjegjësi i Departamentit të respektojë rigorozisht Rregulloren e studimeve të ciklit përkatës.
3. Përgjegjësit e Departamenteve të kordinojnë punën me administratën, sekretarinë mësimore dhe laborantët e Fakultetit për një proces provimesh të rregullt e me atmosfere krijuese.
4. Përgjegjësit e Departamenteve të japin porosi tek anëtarët e komisioneve që vlerësimi i studentëve të bëhet brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e studimit.
5. Një ditë përpara zhvillimit të çdo provimi Përgjegjësit e Departamenteve në bashkëpunim me sekretarinë mësimore të komunikojnë me anëtarët e komisioneve për zhvillimin e provimit në ambjentin dhe orën e përcaktuar.
6. Përgjegjësit e Departamenteve të kërkojnë nga pedagogët që t'i kushtohet vëmendje e veçantë vlerësimit korrekt të studentëve duke evidentuar në këtë mënyrë arritjet dhe mosarritjet e tyre.
7. Në përfundim të provimeve Përgjegjësit e Departamenteve të organizojnë takim me pedagogët në sejcilin program studimi që mbulojnë dhe të bëjnë analizën e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



8. Në përfundim të provimeve Përgjegjësit e Departamenteve të bëjnë me shkrim vlerësimin e punës mësimore për sejcilin pedagog.
9. Për të gjithë ata që nuk do të respektojnë vendimet e marra nga Departamentet për sezonin e provimeve Përgjegjësit e Departamenteve të marrin masa konkrete disiplinore.
10. Zv.Dekani i Fakultetit të koordinojë veprimet për kontrollin e mbarëvajtjes së procesit të provimeve me Përgjegjësit e Departamenteve.
11. Datat e provimeve të afishohen para datës 08.06.2018 në ambjentet e fakultetit, t'ju dërgohen kolegëve pedagogë me e-mail si dhe një kopje të dërgohet në rektorat.
12. Një kopje e këtij urdhëri t'i dërgohet Rektoratit.
13. Urdhëri të vendoset në ambjentet e Fakultetit dhe në faqen web të UART.
14. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri përgjegjësit e njësisë bazë zv/dekani i fakultetit dhe sekretaria mësimore.
15. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

DĒKAN

FAKULTETI I ARTIT SKENIK

